

Data 29.12.2022

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

---

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “ MIRËMBAJTJE E SISTEMEVE FINANCIARE TË BASHKISË TIRANË DHE TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”**

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):** Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit- 72267100-0

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 3,124,000 (tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë) lekë pa TVSH

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1
- d. Lista e çmimeve të shërbimeve sipas Shtojcës 2

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020, 2021 ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: " Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar". Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara....

Si dhe neni 55/4....." Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave."

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë

*vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**2.2.2** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .....Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi*

të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001, ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;
- c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

**Argumentimi 2.3.2/a/b/c:** Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
- c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

**a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;**

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit;**

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

**c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit;**

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate, konkretisht:

Mirëmbajtja e sistemeve:

- Forcimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
- Linearizimi Financiar në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë

**2.3.3** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, realizimin e shërbimeve përkatëse përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim databaze
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues në programim.
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizë software.
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software.
- f. Të paktën (1 një) punonjës të certifikuar në teknologjinë e mbrojtjes së aplikacioneve ose ekuivalente.

*Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime sipas kërkesave më sipër.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkripte për specialistët e kërkuar.
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emër mbiemër) dhe profilin përkatës (çertifikimet respektive);
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër

*Kriteri 2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës a:** 1 (një) punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente.

Një çertifikim ITIL nuk është një premisë thjeshtë për një aktivitet suporti, por një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë natyrën dhe shërbimet e kërkuara, kriteri i mësipërm është një indikator i rëndësishëm në cilësinë e praktikave menaxheriale të Operatorit Ekonomik, deri në përfundim të afateve të mirëmbajtjes sipas kontratës.

Plotësimi i

kësaj kërkesë jep garanci që Operatori ekonomik garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre.

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës b:** b.Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim databaze.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë që Operatori Ekonomik ofertues është i aftë për administrimin e databazës aktuale dhe mirëmbajtjen eficiente të saj. Mënyra më e saktë dhe që paraqet më pak risk për konfirmimin e aftësive të stafit është pajisja me certifikata, dhe paraqitja e tyre si dëshmi kualifikimi. Prania e tyre jep garanci për shërbimet e mirëmbajtjes gjatë periudhës 12 (dymbëdhjetë) mujore, dhe operimin e sigurt me elementët përbërës të databazës.

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës c:** Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues në programim.

Kompetencat e punonjësve të certifikuar si zhvillues në programim, lidhen me nivelin e zotërimit të aftësive teknike, ekspertizën dhe njohuritë e nevojshme për të kryer role komplekse për zhvillimet e sistemeve. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të garantojë që operatori ekonomik ka personel teknik të aftë për të zbatuar kërkesat referuar termave të referencës pjesë e kontratës.

Kjo kontratë synon procesin e mirëmbajtjes së Sistemeve Financiare të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të varësisë, duke u fokusuar por pa u kufizuar në:

- Korrektimin e bug-eve të platformës softuerike
- Azhornime të sistemit në aspektin e sigurisë (dhe jo vetëm) në rastet kur rregullore të reja hyjnë në fuqi apo nëse procese të reja pune nevojiten.
- Shtimi i instancave të reja në rast krijimi të Institucione Varësije të reja apo përmirësime në ato ekzistuese.
- Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sistemet e tjera (integrim)
- Integrim me sisteme të tjera nëse do të jetë e nevojshme.

Për sa më sipër, referuar natyrës objektit dhe shërbimeve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, për realizimin dhe përmbushjen e kërkesave sipërcituara, objekt kontrate, për sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nëpërmjet sistemeve (Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë) që AK disponon, korrigjimin e bug-eve që mund të shfaqen apo dhe për përmirësime të instancave nëse nevojitet, është e domosdoshme prania e punonjësve të certifikuar si zhvillues në programim. Prania e tyre jep garanci për realizimin e shërbimeve respektive të kërkuara në Termat e Referencës.

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës d:** Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizë software.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Një analist software është i aftë të analizojë kërkesat apo proceset e punës të AK në përputhje me sistemet që kërkohen të mirëmbahen. Analisti software është i aftë të bëjë dallimin ndërmjet shërbimeve të ndryshme të sistemit, kategorizimit të problematikave dhe trajtimit të tyre, si dhe të suportojë Autoritetin Kontraktor për formulimin e kërkesave dhe impaktin e tyre në proceset ekzistuese të Institucionit.

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës e:** Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software

Kjo kërkesë i jep garanci autoritetit kontraktor për përmbushjen e kërkesave referuar termave të referencës, ku nevojiten të realizohen edhe aktivitetet e testimit që kanë të bëjnë më çështjet e mirëmbajtjes për të garantuar shërbimin sipas marrëveshjes SLA, si dhe me disa prej shërbimeve të kërkuara për këtë kontratë, konkretisht në pikën 7.2/a “Specifikimet Teknike për Përditësim, Përmirësim apo Modifikim të Sistemit” pjesë e termave të referencës së dokumenteve standarte të tenderit ku AK citon:

## **7.2 Specifikimet Teknike për Përditësim, Përmirësim apo Modifikim të Sistemit**

- a. Kjo kontratë synon procesin e mirëmbajtjes së Sistemeve Financiare të Bashkisë Tiranë dhe Institucioneve të varësisë, duke u fokusuar por pa u kufizuar në:
  - Korrektimin e bug-eve të platformës softuerike
  - Azhornime të sistemit në aspektin e sigurisë (dhe jo vetëm) në rastet kur rregullore të reja hyjnë në fuqi apo nëse procese të reja pune nevojiten.
  - Shtimi i instancave të reja në rast krijimi të Institucione Varësije të reja apo përmirësime në ato ekzistuese.
- b. Transferime te infrastrukturës fizike ku janë hostuar sistemet (nëse do të jenë të nevojshme).
- c. Integrim me sisteme të tjera nëse do të jetë e nevojshme.

Sa më sipër, është e nevojshme dhe e domosdoshme që shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit dhe përmirësimet e sistemit t'i nënshtrohen një procesi të testimit në mënyrë që të eliminohen të



metat/erret në sistem. Për këtë arsye shërbimi i testimit duhet të udhëhiqet nga një specialist i cili zotëron kapacitetet dhe kualifikimin e nevojshëm për realizimin e testeve, duke garantuar mbarëvajtjen e sistemit me të gjithë komponentët përbërës dhe rrjedhimisht të kontratës.

**Argumentimi për kërkesën sipas pikës f:** Të paktën 1 punonjës të certifikuar në teknologjinë e mbrojtjes së aplikacioneve ose ekuivalente.

Kërkesa lidhet me praninë në stafin implementues të Operatorit, të një punonjësi të aktiviteteve të mbrojtjes së aplikacioneve si një nga aktivitetet e vazhdueshme gjatë procesit të mirëmbajtjes së vazhdueshme, objekt kontrate. Prania e tij në staf jep garanci se operatori ekonomik është i aftë të kryejë shërbime profesionale në këtë fushë. Kërkesat e stafit teknik lidhen me nevojën për staf të specializuar për të realizuar detyrat specifike të kontratës.

Një punonjës i certifikuar në teknologjinë e mbrojtjes së aplikacioneve i jep garanci AK për vazhdimësinë dhe vlefshmërinë e shërbimeve që do të ofrojë sistemi për përdoruesit në aspektin e sigurisë.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duke qenë se projekti në vetëvete është një projekt TIK, nisur nga termat e referencës dhe natyra e kontratës që do të prokurohet, kërkesa për staf të diplomuar/ certifikuar në degët/ fushat e sipërpërmendura, për të cilat kërkohet niveli i tyre profesional lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Neni 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto

*rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës:**

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

- Qëllimi kryesor i këtij shërbimi është sigurimi i mirëmbajtjes së sistemeve:
  - Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
  - Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë

duke mundësuar vazhdueshmërinë e funksionaliteteve dhe disponueshmëri të shërbimeve pa ndërprerje.

- Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemeve:
  - Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës
  - Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë.

me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mirëmbajtja parashikohet për një periudhë 1 vjecare (12 muaj).

Sistemet janë të ndërtuar në formë modulare, secili modul ka funksionalitete të vecanta dhe janë pjesë e një platforme të vetme. Sistemet përdoren nga Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, dhe janë të integruar me njëri- tjetrin.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e sistemeve:*

- *Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës*
- *Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucionet e Varësisë të Bashkisë Tiranë, duke mundësuar vazhdueshmërinë e funksionaliteteve dhe disponueshmëri të shërbimeve pa ndërprerje.*

*Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4,*

*pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Mirëmbajtje e sistemeve financiare të Bashkisë Tiranë dhe të Institucioneve të Varësisë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverballi:**

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termtat e referencës/ specifikimet teknike*

**NJËSIA E PROKURIMIT**